REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2011

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare në Republikën e Shqipërisë;
- Duke vlerësuar kontributin e tij në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së këtyre tregjeve;
- Duke vlerësuar rolin e këtij Autoriteti për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut në përgjithësi një informacion cilësor e profesional mbi këto tregje;
- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të:

- Rritjes dhe konsolidimit të pozicionit të Autoritetit në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare dhe përballimit me sukses të sfidave të zhvillimit të tyre;
- Konsolidimit të një veprimtarie pune disavjeçare me produkte konkrete në fushën rregullatore, mbikëqyrëse, të teknologjisë së informacionit, atë kooperuese e konsolidimit institucional;
- Përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullator mbikëqyrës, në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat europiane, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, trajnimit të burimeve njerëzore drejt një mbikëqyrjeje efektive etj.
- Mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, duke garantuar, në të njëjtën kohë, edhe sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur;
- Përdorimit të elementëve të rinj të modelit të mbikëqyrjes me bazë risku, e mbështetur nga platforma elektronike e raportimit AMF In-Reg, të cilët ndihmojnë në analizimin e gjendjes financiare dhe treguesve të operatorëve financiarë;
- Përmirësimit në infrastrukturë, për sa i përket krijimit të rrjetit, këmbimit të informacionit dhe mbikëqyrjes elektronike nga Autoriteti kundrejt operatorëve në tregun financiar jobankar;
- Përmirësimit të punës së Autoritetit në veçanti, për sa i takon aktivitetit licencues, ku vlen të theksohet licencimi i shoqërive të para administruese të fondeve të pensionit dhe investimit, i cili ka ndikuar edhe në rritjen e investimeve të huaja direkte në tregjet e sigurimeve;
- Forcimit të bashkëpunimit me institucionet homologe në rajon dhe institucionet brenda vendit, siç është dhe investimi në ndërtimin e sistemit të shkëmbimit të të dhënave në mënyrë automatike me Ministrinë e Brendshme dhe me Ministrinë e Transportit, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, paraprirë nga nënshkrimi i marrëveshjeve tepër të rëndësishme të bashkëpunimit me këto dy institucione.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2012 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e në veçanti atij nënligjor në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes së stabilizim-asociimit, direktivat e BE-së dhe praktikat e vendeve të veçanta europiane;
- Marrjen e masave teknike dhe organizative, me synim përmirësimin e raportit dëme/prime dhe raportit të shpenzimeve, si sfida në drejtim të rritjes së besimit të konsumatorit dhe përmirësimit të shërbimit;
- Nxitjen e fushatave edukuese për publikun, që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe integritetit të tregjeve;
- Krijimin e hapësirave të nevojshme, që lehtësojnë hyrjen e investitorëve dhe kapitalit të huaj në tregjet financiare jobankare.

10 maj 2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)